



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. Nr. 01 / 1583 / Datë 01 / 09 / 2023

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 98 dhe 101 të Statutit, në mbledhjen e XLV të mbajtur më 04.07.2023, ka miratuar propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2023/24. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme MASHTI) sipas Referencës 01B - Nr.prot. 2755 dt. 07.07.2023.

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve MASTER për vitin akademik 2023/2024

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, në vitin e parë të studimeve MASTER, për vitin akademik 2023/2024, do të regjistrojë **185** studentë të rregullt.

1. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri 23 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
2. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT dhe Senati, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja **2%** . Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri **5** studentë . Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende .
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **2 %** e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht **5** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **1 %** e kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht **2** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
5. Kandidatët nga Shqipëria, mbështetur në marrëveshjen e datës 20.06.2022 e lidhur ndërmjet dy ministrive respektive, mund të regjistrohen edhe në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve me kushte të barabarta me ata kosovarë

6. Të drejtë pranimi në Universitetin “Kadri Zeka” kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses studimet themelore në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
7. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi , Këshilli i njësisë akademike, në propozim të Komisionit të Studimeve, mund të caktoj provime diferenciale të cilave duhet t’iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Numri i provimeve caktohet varësisht nga shkalla e kalueshmërisë / ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit/es. Në raste të tilla , kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve duke filluar në afatin e janarit, prillit, qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri 5 (pesë) provime diferenciale të cilave do t’iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga Këshilli i njësisë përkatëse akademike.
8. Kandidatet te cilët kane diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
9. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
10. Deklarimi i rrejtshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
11. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit Publik “Kadri Zeka” nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
12. Kandidatët për pranim si studentë në nivelin master në Universitetin Publik “Kadri Zeka” Gjilan, në vitin akademik 2022/23 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:**

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë

- **Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;**
- **Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë.**

1. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
2. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
3. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të renditur si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
4. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në zyrën IT-së Hyrja B kati i I, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online **smu.uni-gjilan.net** hapet prej datës **04.09.2023** deri më datë **20.09.2023** në ora **16.00**.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **04.09.2023**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **10:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **04.09.2023** deri më datë **20.09.2023** duke përfshirë edhe ditën e shtunë. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personel i administratës së fakultetit përkatës.
4. Më **21.09.2023** do të publikohet në ueb-faqen e universitetit lista e kandidatëve dhe sallave ku do të mbahet provimi pranues.

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal),*
- b) *Diplomën e fakultetit (origjinal apo të noterizuar), ose certifikatën e diplomës origjinale*
- c) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- d) *Fletëparaqitjen e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT)*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti:*
- g) *Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://smu.uni-gjilan.net>*

P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.

1. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në shërbimin përkatës të Masterit, si dhe në ueb-faqen e universitetit.
2. Provimi pranues do të mbahet të **Premten më datë 22.09.2023**.
Detajet lidhur me kohën e mbajtjes së provimit pranues do të shpallen në ueb faqen e universitetit të Enjten më datë 21.09.2023.
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celulare dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më **25.09.2023** në ueb-faqen e universitetit.
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen shërbimit të studentëve të Masterit ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.smu.uni-gjilan.net

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të pranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preleminare respektivisht për grupet si në vijim: Ankesat bëhen më së voni deri më datë **27.09.2023**, në ora **16:00**;
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet më **28.09.2023** në orën **10.00** nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës .
3. Rezultatet përfundimtare pas ankesave do të publikohen më **29.09.2023**.

V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

Regjistrimi i studentëve të pranuar do të bëhet sipas këtij orari në zyrën e TI-së.

Fakulteti i Edukimit,

- **Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe** më date **09.10.2023** nga ora 9:30-11:30 dhe 13:00-15:00
- **Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor** më datë **09.10.2023** nga ora 9:30-11:30 dhe 13:00-15:00

Fakulteti Juridik,

- **Juridiko - Penal** më date **10.10.2023** nga ora 9:30-11:30 dhe 13.00-15.00

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike,

- **Sistemet e kontrollit dhe inteligjenca artificiale** më date **11.10.2023** nga ora 9:30-11:30 dhe 13.00-15.00
- **E-Qeverisja** më datë **12.10.2023** nga ora 9:30-11:30 dhe 13.00-15.00

Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.



STUDIMET MASTER

Tabela me numrat e paraparë për studentë të rinj për vitin akademik 2023-2024 sipas njësive akademike dhe programeve

Vendet e parapara ne nivelin master për konkursin për pranimin e studenteve te rinj ne vitin akademik 2023/2024								
Niveli	Fakulteti	Programi	Nga Kosova	Nga Lugina e Preshevës 2%	Komunitetet jo shumicë 12%	Nga Maqedonia dhe Shqipëria 2%	Nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Master	Edukim (01)	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (14)	24	1	4	1	0	30
Master		Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor (15)	24	1	4	1	0	30
Master	Juridik (02)	Juridiko - Penal (16)	20	1	3	1	0	25
Master	Shkenca Kompjuterike (04)	E-Qeverisja (18)	41	1	6	1	1	50
Master		Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale (17)	41	1	6	1	1	50
Gjithsej			150	5	23	5	2	185

- Programi E-Qeverisje : Nga numri i përgjithshëm i studentëve pranon 20 studentë të IT-së, 15 studentë të ekonomikut dhe 15 studentë të Juridikut;
- Programi master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe u dedikohet grupeve të ndryshme të kandidatëve si target grupe:
 - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor, në Programin Gjuhë shqipe dhe në Programin Letërsi shqipe, me 240 ECTS;
 - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në programin Gjuhë dhe letërsi shqipe, në Fakultetin e Edukimit, me 240 ECTS.
 - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në Fakultetin e Edukimit (240 ECTS);
 - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në fakultete të tjera përkatëse arsimore (240 ECTS) dhe kanë pasur të paktën 20 ECTS të kurseve nga fusha e didaktikës

PROVIMET PRANUESE

FAKULTETI KOMPJUTERIKE	I	SHKENCAVE
-----------------------------------	----------	------------------

PROGRAMI : Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale
Provimi pranues:

- Shkencat Kompjuterike/Mekatronikë/ Elektronike
- Matematikë

PROGRAMI: E-Qeverisje

Provimi pranues:

- Shkencat Kompjuterike (10 pyetje)
- Logjike (10 pyetje)
- Ekonomik (10 pyetje)
- Juridik (10 pyetje)

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Provimi pranues:

- Gjuhë shqipe,
- Gjuhësi e përgjithshme,
- Letërsi shqipe,
- Letërsi e përgjithshme

PROGRAMI: Mësimdhënie në Kurrikula në Arsimin Fillor

Provimi pranues nga fushat kurrikulare.

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI: Juridiko Penal

Provimi pranues:

- E drejta penale - pjesa e përgjithshme;
- E drejta e procedurës penale - pjesa e përgjithshme dhe
- Kriminologji me penologji.